



## Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët* seancat rifilluan këtë javë. Të hënën dha dëshmi Skënder Zhitia. Dëshmitari ishte anëtar i UÇK-së në zonën operative të Llapit gjatë luftës dhe më vonë shkroi një libër mbi historinë ushtarake të UÇK-së në atë zonë. Në një parashtrim me shkrim në shkurt, u shpjegua se Prokuroria do të mbështetej në dëshminë e dëshmitarit në lidhje me, ndër të tjera, formimin e një njësi konkret të UÇK-së dhe strukturën dhe zhvillimin e një zone operative konkrete.

Të martën dhe të mërkurën, një ish-anëtar i UÇK-së, i cili ishte në Kosovë dhe Shqipëri më 1998 dhe 1999 dha dëshmi me masa mbrojtëse.

Sipas parashtrimeve gjyqësore më herët në maj, dëshmitari iu bashkua UÇK-së më 1999 dhe mbajti një numër pozitash gjatë konfliktit, si rezultat i të cilave fitoi dijeni dhe informacion që lidhen me çështjen gjyqësore. Sipas këtyre parashtrimeve, Prokuroria synonte të mbështetej në deklaratën e dëshmitarit në lidhje me, ndër të tjera: (i) pushtetin e Shtabit të Përgjithshëm dhe komandën e zonës, dhe pushtetin e komandantëve të brigadave mbi njësitet e brigadave; (ii) vendndodhjen e anëtarëve të caktuar të UÇK-së; dhe (iii) anëtarë të UÇK-së të pranishëm në një vend konkret në verën e 1999.

Gjykatësit vendosën të pranojnë deklaratën me shkrim të këtij dëshmitari sipas rregullës 154, çka do të thotë se Mbrojtja do të ketë mundësinë ta marrë në pyetje atë në sallë të gjyqit.

Të mërkurën, një tjetër dëshmitar i mbrojtur filloi dhënien e dëshmisë. Dëshmia e tij vazhdoi dje dhe sot në seancë të mbyllur.

Mbrojtësi i Viktimave në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët* njoftoi Trupin Gjyqësor se këtë javë një viktimë pjesëmarrëse në këtë proces ka ndërruar jetë. Viktima 02/06 u pranua për pjesëmarrje në proces më 21 prill 2021 për shkak se kishte vuajtur dëm fizik dhe mendor si pasojë e mbajtjes në ndalim. Tani janë 153 viktima pjesëmarrëse në proces në këtë çështje gjyqësore, përfshirë viktima shqiptolëse dhe serbfolëse.

Më 22 gusht, në të njëjtën çështje gjyqësore, Administratorja njoftoi Trupin Gjyqësor se ka caktuar me kusht Rodni Dikson si mbrojtës të ri të Kadri Veselit dhe përfundoi emërimin e Ben Emersonit, pas vendimit të Trupit Gjyqësor për pranimin e tërheqjes nga çështja gjyqësore të z. Emerson.

Më 27 gusht, Gjykatësja e Procedurës Paraprake në çështjen gjyqësore të Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit dhe Haxhi Shalës hodhi poshtë kërkesën e Haxhi Shalës për t'u gjykuar veças nga z. Bahtijari dhe z. Januzi. Mbrojtja





argumentoi se, deri më sot, çështja e z. Shala është përballur me vonesa të njëpasnjëshme dhe se do të përballlet më tej me vonesa për shkak të akuzave të reja në aktakuzën kundër z. Bahtijari dhe z. Januzi. Rrjedhimisht, Mbrojtja argumentoi se z. Shala duhet të gjykohet para dy të pandehurve të tjerë, që të garantohet e drejta e tij për gjykim të shpejtë.

Në vendimin e saj, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se, në kundërshtim me pretendimet e Mbrojtjes së Shalës, çështja gjyqësore është caktuar t'i kalohet Trupit Gjyqësor në të ardhmen a parashikueshme, konkretisht dy ditë pas afatit të 2 shtatorit, kur ekipet e Mbrojtjes duhet të dorëzojnë dosjet gjyqësore paraprake të tyre.

Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstatoi gjithashtu se arsyet të cilat çuan në bashkimin e çështjes gjyqësore të z. Shala me atë të z. Bahtijari dhe z. Januzi vazhdojnë të vlejnjë dhe sot. Konkretisht, të tre të akuzuarit akuzohen për të njëjtat vepra penale bazuar në të njëjtat ngjarje, gjatë së cilës pretendohet se u kërcënua një dëshmitar i DHSK-së, përfshirë me kërcënim të rëndë.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, Gjykatësja e Procedurës paraprake hodhi poshtë një kërkesë të Mbrojtjes së Bahtijarit për shtyrje të mëtejshme të afatit për dorëzim të dosjes gjyqësore paraprake, dhe një kërkesë të Mbrojtjes së Januzit për apelim të një vendimi të mëhershëm në lidhje me mangësi të pretenduara në aktakuzë. Sikurse përmendet më lart, afati për dorëzim të dosjeve gjyqësore paraprake të Mbrojtjes është 2 shtatori dhe çështja do t'i kalohet Trupit Gjyqësor dy ditë pas afatit.

